



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot
mbledhja nr. 5/2019

Shkodër, më _____.____.2019

N J O F T I M

për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 53 pika 2, pika 4; nenit 56 pika 2 shkronja “a“ të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Shkodër, ditën e **Hënë, datë 20 Maj 2019, ora 17:00**, në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak, me rend dite si më poshtë:

1. *Për dhënien e mandatit të këshilltarit bashkiak z. Christian Demaj.*
2. *Për dhënien e mandatit të këshilltarit bashkiak z. Lush Marku.*
3. Pr/ Vendim: *“Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Maj 2019“.*
4. Pr/ Vendim: *“Për dhënien e paaftësisë dhe invaliditetit të punës për muajin Maj 2019“, “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Prill 2019“, dhe “Për miratimin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike për kategoritë përfituese të ndihmës ekonomike, për muajin Prill 2019“.*
5. Pr/ Vendim: *“Për një korigjim gabimi në VKB nr. 72, datë 02.10.2018“.*
6. Pr/ Vendim: *“Për dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri për familjen e Bardhyl Toka“.*
7. Pr/ Vendim: *“Për një shtesë në VKB nr. 6, datë 30.1.2018“.*
8. Pr/ Vendim: *“Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2018 të bashkisë Shkodër“.*
9. Pr/ Vendim: *“Për miratimin e Planit të Trafikut dhe Lëvizshmërisë në qytetin Shkodër“.*

10. Pr/ Vendim: “Për disa ndryshime në VKB nr. 82, datë 20.12.2018 dhe rishpërndarje të fondeve”.
11. Pr/ Vendim: “Për ndryshimin e pjesshëm të VKB nr. 51, datë 14.04.2009 “Për miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtëshme shtetërore që kërkohen për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër”, për heqjen nga lista e pasurive të transferuara në pronësi të bashkisë Shkodër, miratuar me VKM nr. 421, datë 2.6.2010, të ndryshuar”, të pronave me nr rendor 45, 58, 65, 109, sipas formularit për heqjen nga inventari i pronave të paluajtëshme shtetërore”.
12. Pr/ Vendim: “Për dhënie pëlqimi për miratimin e vazhdimit të dhënies më qira (procedurë konkurruese) me afat 5-vjeçar për objektin “Njësia thertoresh (therje kafshëve) ndodhur në ZK 1495, Dobraq-Njësia Administrative Rrethinat-Bashkia Shkodër, me sipërfaqe totale 1131 m², (nga të cilat 425 m² objekt, 706 m² truall/shesh funksional), në pasurinë nr 152/2”.
13. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i çështjeve ligjore	E Enjte	16.05.2019	10:00
2	Komisioni i shërbimeve sociale, strehimit dhe çështjeve gjinore	E Enjte	16.05.2019	12:00
3	Komisioni i shërbimeve publike	E Premte	17.05.2019	11:00
4	Komisioni i kontrollit financiar	E Premte	17.05.2019	12:00
5	Komisioni i buxhetit	E Premte	17.05.2019	13:00

Duke ju falenderuar,

K R Y E T A R

Xhemal BUSHATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2019

N J O F T I M

Për ndryshimin e orës së mbledhjes së datës 20 Maj 2019

Të nderuar këshilltarë,

Me propozim të kryetarit të grupit të këshilltarëve të PD-se, me qëllim që këshilltarëve t'ju jepet mundësia për të marrë pjesë edhe në aktivitetin e inaugurimit të monumentit kushtuar viktimave të persekutimit komunist në Shkodër që organizohet në të njëjtën ditë, kryesia e këshillit ka vendosur që mbledhja e datës 20 Maj 2019, të zhvillohet në ora 15:00.

Bazuar në nenin 19 pika 3 e rregullores së këshillit bashkiak, ju njoftoj se mbledhja e datës 20 Maj 2019 do të zhvillohet në **ora 15:00**.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

K R Y E T A R

Xhemal BUSHATI